



Viti i XV-të i Botimit, Nr.2
Dhjetor 2023

RAJONET KULTURORE NJË VËSHTRIM ANTHROPOLOGJIK

Teuta Bajo*

**Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Departamenti Art Dizajn, Albanian University*

Përmbajtja e shkurtër

Lëvizjet e shumta demografike, si rrjedhojë e globalizimit, kanë sjellë ndryshime të mëdha etnike dhe kulturore për shumë vende të ndryshme, duke bërë që gjatë hulumtimeve në shkencat humane të ringjallet interesi praktik e teorik mbi përcaktimin e rajoneve kulturore (Gupta & Fergasus 1997).

Si pasojë e këtyre ndryshimeve, në antropologjinë e Mesdheut studiuesit vëmendje të veçantë i kanë kushtuar zonës së Mesdheut si një rajon me “*ngjashmëri mes vendeve të ndryshme dhe me shumë larmishmëri brenda kufijve të tyre kombëtarë*” (Pitt-Rivers 1963:10). Hapësira e caktuar e këtij rajoni, e parë në nivel makro dhe mikro, tregon një diversitet të madh kulturor brenda kulturës dominante të shoqërisë mesdhetare. Në hulumtimet e zhvilluara nga studiuesit në vendet e Evropës Lindore, koncepti i zonave kulturore është përqëndruar në këndvështrimin mikro-kulturor, dhe si rrjedhojë, shumë prej tyre i emërtojnë krahinat etnografike si zona të vogla kulturore brenda territoreve të një vendi të caktuar. Ndarja e krahinave etnografike si një bashkëveprim ekonomik dhe social-kulturor përcaktohet “*nga faktorë të ndryshëm shoqërorë nga karakteristikat e veçanta të kulturës materiale e shpirtërore*” (Krasniqi 1982:14) që i bënë të dallohen nga njëra-tjetra.

Fokusi ynë në këtë punim, i parë në këndvështrimin mikrokulturor, do të bazohet në kuptimin e rajoneve brenda një hapësire me diversitet të larmishëm. Në veçanti rasti i studimit është Përmeti, një trevë e krahinës së madhe etnografike të Toskërisë në jug të Shqipërisë. Gjetjet e mbledhura gjatë ekspeditave në terren tregojnë se, si rrjedhojë e modernitetit dhe globalizimit, dallimet mes krahinave etnografike, të para si zona kulturore brenda shoqërisë shqiptare kanë ardhur duke u zbehur. Për faktin se, kufijtë etnografikë dhe kufijtë e zonave kulturore janë rezultat i integritetit, ku njerëzit bashkëveprojnë në mënyrë të pandërprerë dhe krijojnë kufij fluidë.

Fjalët kyçe: zona e Mesdheut, mikrokultur, zonë kulturore, krahinë etnografike.

Hyrje

Procesi i globalizimit i shoqëruar me lëvizje të shumta demografike ka sjellë ndryshime në strukturën etnike dhe kulturore për shumë vende. Kjo bëri që gjatë hulumtimit në shkencat humane të ringjallet interesi praktik dhe teorik për sa i përket përcaktimit të rajoneve kulturore (Gupta & Ferguson 1997)¹. Në literaturën e shkencave humane, me termin rajon kuptohet një hapësirë gjeografike *funksionale*² me tipare e veçori natyrore, kulturore dhe ekonomike të dallueshme nga hapësirat e tjera; në të cilat krijohen dhe veprojnë faktorë e struktura lidhesh e bashkëveprimi midis gjithë aktorëve të shoqërisë dhe mjedisit natyror, zhvillimit ekonomik, shoqëror, politik e historik³. Në studimet e tyre studiuesit e përcaktojnë një zonë kulturore duke u mbështetur në grupimin e karakteristikave mjedisore dhe kulturore në thelb uniforme. Sipas Nina Brown *koncepti i një zone kulturore është një rajon [gjeografik] në të cilin njerëzit ndajnë tipare të ngjashme kulturore* (2001).

Antropologët social-kulturorë dhe etnologët⁴ në studimet e tyre përdorin terma si: *rajon kulturor* (Gupta & Ferguson 1997), *zonë kulturore* (Kroeber 1931/1939; Erickson & Murphy 2003; Harris 2001), *sferë kulturore* (Schneider & Barsoux 2003), *krahinë etnografike* (Zojzi 1962; Krasniqi 1977). Pavarësisht termave të ndryshme, kur i referohen një vendi, nënkuptohet një zonë, rajon a hapësirë gjeografike e caktuar e banuar nga njerëz që kanë një ose më shumë tipare kulturore të përbashkëta si gjuhën, besimin, mënyrën e jetesës, doke e zakone, etj.

Koncepti mbi rajonin a zonat kulturore e ka origjinën në gjysmën e dytë të shek. XIX. Ai është formuluar nga kuratorët e muzeve dhe etnografët gjatë punës së tyre në rregullimin e ekspozitave të ndryshme. Franc Boasi (1940), me punën e tij për studimin e kulturave të veçanta, vë në dukje se bota është plot me kultura të ndryshme. Meritat në krijimin e konceptit mbi zonat kulturore i takojnë Clark Wissler (1916/1975) dhe Alfred Kroeber (1939), të cilët hapën premisa në kuptimin e rajoneve a zonave kulturore si standarde më të gjera në bashkëveprimin ekonomik, social e kulturor të njerëzve brenda një hapësire të caktuar në kuptimin makro dhe mikro kulturor. Wissler shkoi përtej kufijve të antropologjisë boasiane dhe me punën e tij etnografike në terren zhvilloi një qasje të mbështetur në të dhënat etnologjike duke i hapur rrugë fokusit analitik të kulturave brenda njësive shoqërore me kultura të ngjashme. Alfred Luis Kroeber zhvilloi më tej konceptin e zonave kulturore dhe «elementeve kulturore» duke u shprehur se: “Një zonë kulturore është një zonë gjeografike me aktivitet relativisht homogjen njerëzor (kulturor), ndërsa një element kulturor është një pjesë thelbësore e asaj që përbën një kulturë” (Kroeber 1939).

Në këtë kuadër edhe studimi ynë duke u nisur nga këndvështrimi mikrolukturor do të bazohet në kuptimin e rajoneve brenda territorit të Shqipërisë, ku diversiteti mes krahinave etnografike është i larmishëm. Fokusi ynë në këtë punim është Përmeti, një trevë e krahinës së madhe etnografike të Toskërisë në jug të Shqipërisë. Gjetjet e mbledhura gjatë ekspeditave në terren tregojnë se, si rrjedhojë e modernitetit, globalizimit, bashkëveprimit të njerëzve në mënyrë të pandërprerë dhe integritetit të tyre në shoqëri, dallimet mes krahinave etnografike të para si zona kulturore brenda shoqërisë shqiptare, kanë ardhur duke u zbehur duke bërë që kufijtë etnografikë dhe të zonave kulturore të krijojnë kufij fluidë. Punimi është i ndërtuar në këtë mënyrë: në fillim paraqitet antropologjia e Mesdheut dhe debati teorik, së dyti një prezantim i mendimit teorik i studiuesve shqiptarë mbi krahinat etnografike dhe së treti, metodologjia, këndvështrimi etnografik i trevës së Përmetit dhe konkluzionet nga ky studim.

1 Shih Gupta, A. & Ferguson, J., 1999, *Beyond “Culture”: Space, Identity, and the Politics of Difference*, in Culture, Poëer, Place: Explorations in Critical Anthropology, Durham, N.C. and London: Duke University Press, p.33-51.

2 Ka kuptimin e hapësirave territorial ku ndërveprimi midis njeriut dhe natyrës është një dukuri e brendshme, nga varet veprimtaria ekonomike, si dhe lidhjet e ndërsjellta që krijohen ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore.

3 Shih Pauls E. P., 2009, *Cultural Area, Anthropological Concept*, Encyclopedia Britannica.

4 Kështu njihen në Evropën Lindore studiuesit që u morën me hulumtimet brenda territorit të vendit të tyre.

Antropologjia e Mesdheut dhe debati teorik

Megjithëse disa studiues evropianë spanjollë⁵ shprehin mendimin se Antropologjia e Mesdheut ka lindur më herët, në fillimet e shekulli XX hulumtimet mbi zonën e Mesdheut erdhën duke u rritur. Gjatë viteve 20-30 të këtij shekulli për shumë antropologë *“fokusi i vëmendjes u zhvendos nga studimi i popujve fisnorë drejt studimit të fshatarëve në Azi, në Amerikën Latine dhe gjetkë”* (Alberta 1999:215). Në dekadat e para pas Luftës së II-të Botërore, të shoqëruara me transformime ekonomike, shoqërore dhe politike si rrjedhojë e procesit të dekolonizimit, interesi për kërkime mbi zonën e Mesdheut erdhi në rritje. Hulumtimet etnografike “moderne” të viteve 50 të këtij shekulli shënuan zhvillimin e një perspektive krahasuese për rajonin e Mesdheut. Ato i hapën rrugë krijimit të antropologjisë së Mesdheut, e cila do të marrë kuptimin e plotë brenda kësaj fushe gjatë viteve 60 të shekullit XX dhe legjimiteti i saj do të realizohet me organizimin e një numri konferencash dhe seminaresh nga shkolla amerikane e Miçiganit dhe ajo britanike e Oxfordit.

Perspektiva e hapur nga Julian Pitt-Rivers (1963), i cili vendoste pranë Europën Jugore dhe Lindjen e Mesme, shënoi *“ndërtimin e një specialiteti pan-mesdhetar në antropologji”* (Alberta 1999:217). Në këtë kuadër fokusi i studimeve në monografitë etnografike deri në fund të viteve 60 u zhvillua mbi rrjetet sociale, ekonomike, politike dhe fetare, të cilat ndërmjetësuan mes niveleve të ndryshme, identifikimin e grupit në brigjet e Mesdheut⁶.

Përpjekjet e Davisit (1977) dhe Boissevanës (1979) që *“vendosën themelin e parë për ndërtimin e një nënspecialiteti të dallueshëm “mesdhetar” në antropologjinë sociale”* (Gilmor 1982:176), si dhe kërkimet e bëra mbi komunitetet e veçanta që *“përcaktuan një antropologji sociale të Mesdheut, e cila do të zhvillojë shqyrtimin kritik dhe shtrimin e pyetjes serioze mbi “ndërtimin e Mesdheut”* (Alberta 1999:218) do të ndikojnë në përcaktimin si një zonë studimore jo vetëm nga ana gjeografike, por edhe kulturore në këndvështrimin antropologjik.

Studimet krahasuese, që u botuan gjatë viteve 70 të shekullit të kaluar dhe në vitet në vazhdim nga Black-Michaud (1975), Gulick (1976), Hopkins (1980), Blok (1981), Gilmor (1987) e të tjerë, sollën rritjen e diskutimit mbi vetë nocionin “vend” të rajonit të Mesdheut, pasi “vendi” për antropologët është një domosdoshmëri jetike në studimet e tyre. Siç shprehet Appadurai *“është jetësor në antropologji, sepse siguron lidhjen midis mikroanalizës dhe krahasimit, ose përgjithësimin për nocionin si zonë kulturore, rajon, komb, shoqëri dhe qytetërim”* (1986). Debati u zhvillua mbi kriteret që e bëjnë të dallueshëm përcaktimin e Mesdheut si nga ana gjeografike, ashtu edhe ajo kulturore.

Debati mbi konstruktimin e Mesdheut si një rajon gjeografik dhe kulturor e arrin kulmin me studimin e John Davisit. Në librin *“Popujt e Mesdheut”* (The people of the Mediterranean), megjithëse Davis nuk përcaktoi ose shpjegoi termin “Mesdhe”, shprehu mendimin se uniteti i popujve të Mesdheut *“është një unitet që buron përgjatë një periudhe mijërvjeçar... ku ata janë sulmuar, kolonizuar, konvertuar dhe gjithashtu kanë këmbyer... e kanë krijuar lidhje martesore, si rrjedhojë e një kontakti të përhershëm dhe të pashmangshëm”* (1977:255). Për David Gilmore-in ky *“unitet shfaqet si në mënyrë sinkronike ashtu dhe diakronike nga një analizë e pajtimit unik të të gjithë faktorëve”* (Gilmore 1982:184) gjeografik, ekologjik, politik, ekonomi dhe kulturor. Ishte Michael Herzfeld ai që shpiku termin e “Mediterranizmit” [Mediterraneanism], sipas të cilit *“Mediterranizmi është një term që me shumë qëllim i ofrojmë modelit të historicizmit, pozitivizmit dhe monedhës ironike të “orientalizmit” të Said-[it]”*. Kjo perspektivë kishte si synim dallimin e Mesdheut si një *“zonë kulturore me ndryshime kulturore nëpërmjet një përfaqësimi të ndryshëm të motivuar ideologjikisht”* (Hertzfeld 1987:64).

Në vitet 1990 konsolidimi i Bashkimit Europian dhe ringjallja e Islamizmit politik, të shoqëruara me

5 Shih Aceves, Joseph B., 1979, *CA comment*, Current Anthropology 20, p.85; Esteve-Fabregat, C., 1979, *CA Comment*, Current Anthropology 20, p. 405-408

6 Shih Silverman, S., 2000, “Defining the anthropological Mediterranean: before Aix 1966”, Di-onigi Albera, Anton Blok and Christian Bromberger (eds.), *L’anthropologie et la Méditerranée: unité, diversité et perspectives*, Paris: Éd. de la Maison des Sciences de l’Homme.

ndryshime demokratike dhe lëvizje të shumta demografike, bënë që diskutimet mbi Mesdheun të vijnë në rënie. Kjo, sipas Dionigi Albertas, shënon një periudhë “hijëzimi” relativ të “Mesdheut” si kategori krahasuese në diskutimin antropologjik (1999).

Këndvështrimi analitik dhe krahasues i hulumtimeve të antropologjisë së Mesdheut u zhvillua mbi komunitetet e fshatrave dhe fokusi i studimeve u drejtua mbi problemet jetësore, vlerat shoqërore si: nderi e turpi, mikpritja e miqësia (Schneider 1971; Hertzfeld 1980) farefisnia e fqinjësia, ndarja gjinore dhe e punës, lidhjet martesore dhe marrëdhëniet burrë-grua, lidhja e komuniteteve lokale me njësitë më të mëdha shoqërore, partneriteti padron-klient (Boissevanin 1979; Campell 1964; Davis 1977; Loizos 1977 etj.). Studimet nga njëra anë tregojnë përcaktimin e Mesdheut si një rajon që ka unitet, i cili rrjedh nga kohezioni historik, pozita gjeografike, ekologjia deri diku e njëjtë, ndarja e ngushtë seksuale në familje dhe shoqëri, faktorë fetarë dhe ritualë (Geertz 1968; Braudel 1972), regjime të paqëndrueshme demokratike, por nga ana tjetër shprehin një diversitet të larmishëm brenda shoqërive mesdhetare. Ky diversitet rrjedh nga fakti se të gjitha shoqëritë rreth Detit Mesdhe janë shoqëri komplekse, faktor ky që e bën “komunitetin e Mesdheut të ketë ngjashmëri mes vendeve të ndryshme, por dhe shumë larmishmëri brenda kufijve kombëtarë” (Pitt-Rivas 1963:10).

Mendimi teorik i studiuesve shqiptarë

Antropologjia social-kulturore në vendet e Evropës Lindore, mes të tjerave edhe në Ballkan e Shqipëri është njohur me termin etnografi/etnologji. Nisur nga këndvështrimi mikrokulturor hulumtimet e kryera nga studiuesit brenda territoreve të vendeve të tyre bënë të mundur zhvillimin e një “antropologjie në shtëpi”. Edhe “*etnografia shqiptare*, [e cila u zhvillua brenda kufijve kombëtarë], si një disiplinë e dijeve albanologjike u përqëndrua në studimin e kulturës shqiptare me fokus kryesor kulturën tradicionale dhe gjetjen e kulturës origjinale shqiptare” (Bardhoshi 2011:133). Studiuesit, duke vënë në dukje një diversitet të larmishëm brenda shoqërisë dominante shqiptare, zonat kulturore, të para në këndvështrimin mikrokulturor në mënyrë analoge me antropologjinë e vendeve perëndimore, i kanë identifikuar me krahinat etnografike.

Sipas etnologut Rrok Zojzit me “*krahinë etnografike kuptojmë njësitë e vogla ekonomike shoqërore që u formuen historikisht në një popullsi me jetë ekonomike, territor, drejtim politik etj. të veçanta nga krahinat e tjera*” (1962:16). Edhe në Fjalorin enciklopedik shqiptar termi krahinë etnografike ka kuptimin e një treve të caktuar, ku prej kohësh banon një bashkësi ekonomike-shoqërore njerëzish, me kushte shoqërore të njëjta dhe me mënyrë të përbashkët jetese⁷.

Për studiuesit që patën si fokus të punës së tyre shoqërinë dhe kulturën shqiptare përcaktimi i krahinave etnografike ka qenë një problem qendror. Megjithatë veprimtaria shkencore është e kufizuar, vetëm në përpilimin e një liste me përshkrime të shkurtra të tipareve të tyre dhe në hartimin e disa katalogëve mbi veshjet popullore sipas rretheve etnografike, debati teorik është zhvilluar mbi ndarja e krahinave etnografike si një bashkëveprim ekonomik dhe social-kulturor. Në dallim nga antropologët perëndimorë, studiuesit shqiptarë që e kishin të përcaktuar terrenin e tyre të studimit, në lidhje me nocionin vend, pyetjet i ngritën mbi faktin se mbi cilat baza dhe kritere do të bëhet klasifikimi i krahinave etnografike.

Teoria e Etnologu Rrok Zojzi në punimin e tij “*Ndamja krahinore e popullit shqiptar*” (1962) është se formimi i krahinave etnografike është një proces i gjatë historik. Ato me ndryshimin e kushteve të veçanta të jetës pësuan ndryshime dhe disa u zhvilluan e u bënë krahina më të mëdha, kurse disa të tjera u zvogëluan apo u shkrinë me krahina të tjera dhe në kujtesë ruhen vetëm si emërtime. “*Prandaj, -shprehet ai, - ato duhen parë jo si forma statike e në një gjendje të qëndrueshme dhe të pandryshuar gjatë shekujve, por si kategori historike që lindën, u zhvilluan dhe shkuan drejt transformimit të tyre*”. Gjithashtu Zojzi përcakton dhe metodologjinë e punës për të arritur në konkluzione të sigurta me baza shkencore. Meqenëse të dhënat janë të pakta dhe “*sot për sot mungojnë*”, ai vlerëson punën në terren dhe

7 Fjalori enciklopedik shqiptar, 1985, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, faqe 543.

bashkëpunimin e studiuesve të të gjitha fushave të albanologjisë, të cilët sipas tij duhet të mbështeten në atë çfarë ka mbetur në *“formën e mbeturinave në ndërgjegjen e popullit, nëpërmjet gojdhaneve, legjendave, etnonimeve e toponimeve”*. Kjo për arsyen që të bëhet një analizë e detajuar e mbështetur në të gjitha *“të dhënat e kombinuara gjuhësore, antropologjike, etnografike, historike”*.

Studiuesi Mark Krasniqi në *“Ndarjen etnografike të Kosovës”* (1977/1982), jep mendimin se në përcaktimin e kriterëve të krahinave etnografike *“rëndësi të posaçme kanë elementët etnografikë – veshjet, doket e zakonet, por edhe gjuha e disa elemente të tjera (antropologjik, psikologjik, etj.)”*. Megjithëse, vlerëson faktorët gjeografik dhe i sheh të rëndësishëm në formimin dhe ndarjen e krahinave etnografike, ai shpreh se *“ndarja e krahinave etnografike paraqet vështirësi më të mëdha sesa për krahinat gjeografike”*. Vështirësia qëndron në faktin se përcaktimi i krahinave gjeografike varet nga elementet gjeografike të pandryshueshme, ndërsa i krahinave etnografike varet nga faktorë shoqërorë, e veçanërisht nga kultura materiale e shpirtërore, të cilat i bënë të dallohen nga njëra tjetra. *“Këta faktorë mund të ndryshojnë,... të gërshetohen, ose të zhduken fare si tipare të veçanta dhe të njësohen në përmasa më të gjëra me vise të tjera”*. Rëndësi i kushton përcaktimit të kufijve të krahinave etnografike. Ai thekson se *“përcaktimi ndërmjet kufijve të krahinave është më i vështirë”*, sepse kufijtë e tyre *“nuk paraqiten me vija të prera”*. Kjo për faktin se elemente të një krahine mund të gjenden në të dyja anët e kufijve ndërkrahinorë. Sikurse edhe Zojzi si metodologji të kërkimit përcakton punën në terren dhe bashkëpunimin e të gjithë studiuesve.

Në formimin e krahinave etnografike kanë ndikuar shumë faktor si ata: gjeografikë, ekonomikë, shoqërorë, politikë, të cilët u zhvilluan gjatë një procesi të gjatë historik brenda një hapësire me bazë të njëjtë etnike. Mjedisi dhe kushtet gjeografike janë faktorët fillestarë të krijimit të krahinave etnografike. *“Shpeshherë një tërësi etnografike është njëkohësisht edhe tërësi gjeografike”* (Krasniqi 1982:14). Faktorët natyrorë: pozita gjeografike, relievi, klima, tokat, bimësia, diktuan veprimtarinë ekonomike të banorëve që jetonin brenda së njëjtës hapësirë territoriale. Këto të fundit shkuan drejt krijimit të njësisë të vogla ekonomike dhe shoqërore si krahina gjeografike. Disa nga krahinat etnografike për nga territori mund të përputhen me krahinat gjeografike, por disa të tjera ruhen në kujtesë me emrin dhe traditat e kulturës së formave paraardhëse. Forcimi gjithnjë e më shumë i komunikimit reciprok e të ndërsjellët, gjatë një procesi të gjatë historik çoi në krijimin e një tradite kulturore me norma e praktika të përbashkëta që i dallonte krahinat nga njëra tjetra. Këto dallime u vënë re si në nuanca gjuhësore ashtu edhe në mënyrën e jetesës, veshjen, doket e zakonet, mënyrën e organizimit etj., të cilat janë memorizuar *“në ndërgjegjen e vetëdijes e popullit”*.

Studiuesit shqiptarë⁸ të bazuar mbi veçoritë dhe nuancat gjuhësore, që dallohen nga njëra-tjetra prej disa tipareve fonetike, gramatikore dhe leksikore kanë arritur në dallimin e dy variacioneve të së folurës shqipe, gegërishte dhe toskërishte. Kjo ndarje gjuhësore përkon me dy grupet e ndarjes më të mëdha krahinore të Shqipërisë në atë të Gegërisë në veri të lumit Shkumbin dhe atë të Toskërisë në jug të tij, *“të cilat gëzuan për një kohë të gjatë historike jetë ekonomike, territor, ndërgjegje, drejtim politik të veçantë, të cilat u shprehën edhe me të folme, tradita kulture dhe emna të veçantë”* (Zojzi 1962:17). Megjithëse sot këto ndryshime, si rrjedhojë e përdorimit gjithmonë e më shumë të gjuhës letrare, janë bërë më pak të dallueshme, përsëri vihen re akoma disa ndryshime në zanoret hundore që përdoren në dialektin geg dhe të zanores gojore që përdoret në dialektin tosk⁹.

Gegëria dhe Toskëria, si ndarjet më të mëdha të popullit shqiptar nga pikëpamja historike-etnografike përveç dallimeve në të folurën e veçantë, dallohen edhe nga kultura materiale në veshjen e burrave. Karakteristikë e veshjes së burrave në Gegëri ishin tirqet, ndërsa në Toskëri fustanella; si mbulesë koke në Gegëri nga burrat përdorej qeleshja, ndërsa në Toskëri takija. Sot burrat e moshuar në fshatrat e Toskërisë përdoret kasketa, ndërsa në qytet kapele republike. Në veri në disa krahina vazhdon të përdoret qeleshja kryesisht nga të moshuarit në moshë madhore. Dallimet vihen re edhe në kulturën artistike veçanërisht në mënyrën e të kënduarit. Në Toskëri mbizotëron muzika polifonike, kurse në Gegëri muzika monofonike.

8 Gjinar, Jorgji & Shkurtaj, Gjovalin, 1997, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2000.; Jorgji Gjinar, 1964, *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, Studime Filologjike 4, f. 127-144.

9 Shih. Fjalorin Enciklopedik Shqiptar 1985, *Dialektet e gjuhës shqipe*, f. 188

Ndonëse organizimi shoqëror paraqitet i njëjtë, e drejta zakonore u ruajt më shumë në Gegëri. Në Toskëri si rrjedhojë e lëvizjeve të shumta të popullsisë ajo e humbi fuqinë e saj dhe sot disa norma dhe praktika ruhen në kujtesën e popullit.

Metodologjia

Në këtë punim duke u nisur nga këndvështrimi se shumë mikrokultura mund të ekzistojnë brenda makrokulturës, fokusi ynë është drejtuar në jug të Shqipërisë, në Përmet. Përmeti, me një sipërfaqe prej 928 km² paraqitet si një zonë multikulturore dhe është i ndarë në tetë njësi të vogla etnografike. Këto janë: Mallëshova, Rrëza, Shqeria, Cerja, Dangëllia, Dëshnica, Derveni dhe Karama-mutasi. Dy të fundit janë memorizuar në kujtesën e më të moshuarve me emrat e tyre, por nuk njihen nga brezi i ri. Gjatë punimit do të përdorim termat trevë për zonën e Përmetit¹⁰ dhe krahinë për njësitë e vogla etnografike, sepse edhe në popull ato njihen me këto emërtime.

Për realizimin e këtij punimi u mbështetëm krahas literaturës së shfrytëzuar mbi trevën e Përmetit, edhe në mbledhjen e materialit në ekspeditat e kryera në terren gjatë periudhës 2015-2018. Mangësitë gjatë kërkimit ishin hasja me një terren pothuaj të braktisur. Fshatrat në zonat e thella malore, që janë larg rrugës nacionale, pothuaj janë kthyer në gërmadha me shtëpi të rrëzuara e rrugë të prishura. Numri i familjeve shkonte nga 3 deri në 9. Frashri që dikur kishte qenë një qendër e madhe tani kishte vetëm 7 familje. Banorët janë larguar pas viteve 90 të shekullit të kaluar në qytetin e Përmetit, si dhe në qytetet tjera të Shqipërisë, por më shumë në drejtim të Tiranës, Durrësit, gjithashtu edhe jashtë kufijve në Greqi e Itali.

Për të realizuar qëllimin e punës sonë, krahas bisedave me banorët të cilët jetonin ende në fshatrat që ne vizituam, mundëm të krijojmë kontakte edhe me banorë të larguar në qytetet Kuçovë, Patos, Fier, Tiranë, Durrës që nga vitet 50-60 të shekullit të kaluar dhe me ata që ishin larguar dhjetëvjeçarët e fundit.

Bisedat me bashkëbiseduesit i drejtuam mbi pyetjen se: *si e identifikonin veten e tyre banorët e kësaj treve; nga cila krahinë janë dhe cilës krahine i përket fshati i tyre*. Për të bërë dallimin e elementëve etnografike u mbështetëm në atë çfarë është memorizuar në kujtesën e banorëve ekzistues dhe të larguar, kryesisht të moshave më të mëdha. Kjo për 2 arsye: së pari ajo çfarë është tradicionale, si rrjedhojë e modernitetit dhe e zëvendësimit të normave të “shoqërisë së re” gjatë periudhës së socializmit, është zbehur gjithmonë e më shumë; së dyti të rinjtë janë pak ose aspak të interesuar për ruajtjen e traditave të vjetra dhe shprehen se ajo çfarë është e vjetër është e dalë jashtë mode, pra demode.

Burimet për trevën e Përmetit

Për trevën e Përmetit studimet me karakter etnografik janë të pakta. Rezultojnë shënime të botuara të udhëtarëve të huaj, që i takojnë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, ku gjejmë fragmente të shkëputura që flasin për trevën e Përmetit¹¹. Para Çlirimit gjejmë të botuara këngët përmetare dhe disa rite në përmbledhje të ndryshme¹² nga autorë shqiptarë dhe të huaj, si edhe nëpër revista të kohës¹³. Në gjysmën e dytë të shekullit XX janë bërë disa ekspedita kërkimore-shkencore¹⁴ të kryera në këtë trevë.

10 Sot Përmeti është i ndarë në dy bashki të pavarura nga njëra tjetra, atë të Përmetit dhe të Këlcyrës.

11 Pulëvill, Bozhur, shih Stilian Adhami

12 Mitko. Th., 1878 “Bleta shqiptare” Kajro; Dozon. A., 1879, “Visaret e Kombit”, vëll.V, Tiranë, 1941; vëll.XIII, Tiranë, 1943;

13 “Ora”, “Edukata e Re”, “Shkolla kombëtare” etj.

14 Ekspedita etnografike në luginën e Vjosës 8 Maj-16 Qershoe 1950; ekspedita për mbledhjen e krijimeve folklorike në Dangëlli, 1953; ekspedita shqiptaro-gjermane, 1957; në Derven, Malëshovë e Dëshnicë, 1957; në Përmet 1964; ekspeditat në vitet 1971, 1986, 1987, 1989 etj. materialet e të cilave gjenden në Arkivin e Folklorit në Institutin e Kulturës Popullore. (sot Institutin e Anthropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit)

Me qëllim mbledhjen e kulturës materiale dhe shpirtërore, me porosi të Institutit të Kulturës Popullore (sot Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i Studimit të Artit) në rrethe të ndryshme si edhe në fshatra, u ngritën grupe pune, kryesisht nga mësues dhe njerëz të arsimuar; të cilët punuan edhe për hartimin e historikëve të fshatrave. Materialet e mbledhura janë të arkivuara pranë IAKSA. Disa dosje të historive të fshatrave gjenden edhe në arkivin e Qendrës Multikulturore në Përmet, por sipas punonjësve dhe nga ajo që ne pamë vet në shqyrtimin e tyre shumë prej dorëshkrimeve ishin të dëmtuara. Botimet e deritanishme për Përmetin janë më tepër tekste të mbledhjeve të krijimeve folklorike të këngës përmetare¹⁵, artikuj të veçantë¹⁶, në të cilët folklori përmetar është objekt studimi. Dekadat e fundit janë botuar shkrime të studiuesve dhe autorëve shqiptarë me karakter historik¹⁷, në të cilat gjejmë mjaft të dhëna etnografike. Gjithashtu përmendim edhe disa botime të shkruara si kujtime nga përmetarë që flasin për historinë e fshatrave të ndryshëm të kësaj treve.

Këndvështrimi etnografik i trevës së Përmetit

Përmeti kufizohet në lindje me krahinën e Leskovikut dhe të Kolonjës, në perëndim me Tepelenën, në veri-perëndim me Beratin, në veri me Skraparin dhe Korçën, në jug-perëndim me Gjirokastrën dhe në jug me Greqinë. Relievi është kodrinoro-malor, me lartësi mesatare 810 m mbi nivelin e detit. Rreth 65% e sipërfaqes prej 929 km² shtrihet në lartësinë nga 300-1000 m mbi nivelin e detit, kurse rreth 35% shtrihet në lartësinë 1000-1500 m. Dallohet për klimë mesatare mesdhetare, ku në varësi të relievit vihen re tre zona klimatike: mesdhetare-kodrinore (lugina e Vjosës), mesdhetare-paramalore në lindje, malore në jug dhe në perëndim. Hidrografia është shumë e pasur. Lumi Vjosë e përshkon përmes gjithë trevën e Përmetit. Në shtratin e Vjosës derdhin ujërat zalli i Dëshnicës, lumi i Çarçovës, Lomnicës, Langaricës dhe i Zagorisë. Në të majtë të luginës së Vjosës shtrihet vargu malor Trebeshin-Dhëmbel- Nëmërçk, ndërsa në të djathtë zona malore që njihet me emrin vargu Qarisht-Dangëlli-Postenan. Rrjedha e lumit Vjosë pasi hyn në territoret e Shqipërisë, pranë Tri Urave¹⁸ dhe deri në grykën e Këlcyrës, ku bashkohet me lumin e Zagorisë, përfshihet brenda territoreve të Përmetit dhe më pas vazhdon rrjedhën në drejtim të Tepelenës.

Treva e Përmetit paraqitet si një zone multikulturore, e cila përfshin në vetvete disa njësi të vogla etnografike që Zojzi i quan “*rrathë etnografike*”¹⁹, por vetë përmetarët i emërtojnë krahina. Lugina e Vjosës shërben si kufi ndarës i dy uniteteve të mëdha me karakter etnografik individual, të cilat populli i njeh me emra të veçantë, Toskëri dhe Labëri. Toskëria shtrihet në të djathtë të rrjedhës së Vjosës, ndërsa Labëria në të majtë të saj dhe të dyja bëjnë pjesë në grupin e madh etnografik të Toskërisë. Pavarësisht kësaj, përsëri banorët që jetojnë në të majtë të rrjedhës së Vjosës, kur i pyet se me kë ngjajnë traditat e tyre, në krahinën e Malëshovës të përgjigjen se “*për nga tradita ngjajnë më shumë me Labërinë, se sa me Toskërinë, dhe se të vjetrit dikur e quanin veten e tyre leber e jo toskë*”. Ndërsa në Krahinën e Rrëzës disa e quajnë veten e tyre toskë, të tjerë nuk dinë të përgjigjen, por thjesht thonë “*ne ndryshojmë në disa zakone dhe tradita nga ata përtej lumit*”.

Ndryshime të vogla vihen re në ritet e dasmës, vdekjes, lindjes, si dhe në praktikat e ndjekura për organizimin brenda krahinave, fshatit dhe familjes, të memorizuara në kujtesë. Kur i pyesim “*përse ndodhte kështu në krahinën ose fshatin e tyre*”, për të treguar se ishin ndryshe nga të tjetër përgjigjeshin “*fshat e zanat, shtëpi e tarbajat*”. Kjo shprehje thuhej me kuptimin se çdo fshat, familje dhe më gjerë kishte mënyra

15 “Këngë popullore lirike”, Tiranë 1955; “Këngë të LNÇ dhe ndërtimit të socializmit”, vëll. II, Tiranë, 1971; vëll. III, Tiranë, 1976, vëll. IV, Tiranë 1976; “Lirika popullore” 3, Tiranë, 1981; Xhangolli A. & Tyto N., 2006. *Këngë popullore të rrethit të Përmetit*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.

16 Haxhihasani Q., 1959, *Kërkime dhe vëzhgime folklorike në rrethin e Përmetit*, Buletin i Institutit të Shkencave, nr.2, f. 118-158; Panajoti J., Bogdani R., Kurti B., 1973, “*Vatra e kulturës*”, nr.4,5,6; 1974, nr.1.

17 Nuri Dragoti, Dhimitraq Loli, Stilian Adhami, Selami Pulaha, Artan Pulaha

18 Quhen tre urat sepse atje bashkohen tre urat

19 Raporti i ekspeditave të mbajtura në Luginën e Vjosës 1950. ASA, Etnografi

të ndryshme se si rregullonte marrëdhëniet brenda dhe jashtë bashkësisë së vet. Ndonëse shprehja merr edhe kuptime të tjera në mënyrë simbolike, ajo në thelb shpreh diversitetin e larmishëm si dhe kufijtë social të disa normave dhe praktikave të ndryshme, të njohura nga popullit si “zakone” a “tradita”, që zbatohen brenda një treve në shoqërinë shqiptare duke e bërë atë të dallueshme nga trevat apo krahinat e tjera.

Pavarësisht diferencimeve të vogla që bëjnë me mes tyre, përsëri kur i pyet *se nga janë*, të gjithë identifikohen duke u përgjigjur se janë përmetarë. Të qenit përmetar u jep një lloj krenarie, sepse në opinionin shqiptar, përmetarët konsiderohen njerëz punëtorë, të urtë dhe të matur. Këtë e vumë re edhe gjatë ekspeditës në terren. Bashkëbiseduesit dalloheshin për një urtësi në të folur që të dukej sikur i “peshonin fjalët” që thoshin. Dikush prej tyre edhe u shpreh: *“Ne përmetarët zor se e turbullojmë ujin. Por që një përmetar të të bëjë keq duhet që ta kesh prekur deri atje sa nuk mban më ose si i thonë “ta kesh shkelur në kallo”*.

Krenarinë si përmetarë, sipas tyre, ua shtonin edhe dy arsye të tjera: së pari, sepse kudo që ata kanë vajtur, si brenda dhe jashtë vendit kanë krijuar një opinion të mirë, si njerëz punëtorë, të ndershëm, mikpritës dhe që e ruajnë traditën; së dyti e lidhin me faktin se në Përmet, si në fshat edhe në qytet, nuk kishte vjedhje e flinin me dyer të hapura. Gjithashtu periudha e tranzicionit, pas rënies së sistemit diktatorial, nuk u shoqërua me shkatërrime dhe vandalizma, por me qetësi dhe mençuri përmetarët i pranuan ndryshimet ngadalë.

Në ditët e sotme, janë të moshuarit, që ruajnë në kujtesë pak nga elementet kulturore të trashëguar. Sot brezi i ri, që u rrit nga prindër të cilët u formuan me ideologjinë e “Njeriut të Ri të socializmit”, janë pak ose aspak i interesuar për t’i njohur, dhe shprehen se çdo gjë e vjetër është demode dhe e prapambetur. Po të pyesësh të rinjtë se cilës krahine i takon fshati i tyre ata ngrenë supet dhe nuk e dinë, vetëm thonë se janë përmetarë.

Përmeti ndahet në tetë krahina etnografike: Malëshova, Dëshnica, Rrëza, Shqeria, Cerja, Dangëllia dhe dy krahina të cilat nuk janë të memorizuara në kujtesën e banorëve të sotëm të kësaj zone, por që janë përmendur në dokumente deri në vitin 1912, Derveni dhe Karamamutasi.

Në fshatrat kufitare mes krahinave vërehet një lëvizshmëri e kufijve krahinorë dhe elemente të kulturës materiale e shpirtërore, kështu që kufijtë nuk janë shumë të prerë e të qartë. Përrenjtë dhe lumenjtë kanë shërbyer si kufij ndarës mes krahinave. Lëvizjet e popullsisë, lidhjet martesore, bashkëveprimi ekonomik të diktuar nga koha, si dhe ndryshimet ekonomike, shoqërore e politike kanë bërë që kufijtë mes krahinave të jenë të paqëndrueshëm e jostatikë. Pikërisht në zonat kufitare shumë nga bashkëbiseduesit na thoshin se fshati i tyre dikur ka qenë në një krahinë tjetër, por sot ai përfshihet në një tjetër krahinë kufitare me të.

Pyetja e radhës që vazhdon bisedën gjatë kërkimit në fshatrat kufitare mes krahinave ishte se *nga cila krahinë jeni dhe cilës krahine i përket fshati i tyre*. Përgjigjja sigurisht vjen duke treguar se fshati është pjesë e njëres prej krahinave të Përmetit. Ndërsa në kufijtë mes krahinave disa fshatra ruajnë në kujtesë se dikur fshati i tyre ka qenë pjesë e krahinës tjetër kufitare.

Në fshatrat Fratar dhe Seničan, që ndodhen në kufij me krahinën e Cerjes, sipas më të vjetërve thuhej se kishin qenë më parë pjesë e kësaj krahine, ndërsa sot përfshihen brenda territoreve të krahinës së Dëshnicës. Në fshatin Kuqar, lagjja që ndodhej përtej përroit të Shipkës, nga ana jugore, quhet Cerje. Banorët e vjetër të kësaj lagjeje thonë se janë pjesë e krahinës së Cerjes, bile edhe krushqitë i bënin më tepër me fshatrat e krahinës së Cerjes dhe jo me Dëshnicën, sikurse banorët e tjerë në anën tjetër të përroit.

Në fshatit Çarçovë na thanë se fshati i tyre i takon krahinës etnografike të Shqerisë, megjithëse ndodhen përtej lumit të Çarçovës, që shërben si kufiri ndarës i Karamamutasi me Sheqrinë. Po ashtu edhe banorët e fshatit Buhall, nuk e përmendin emrin e Dervenit, por thonë me bindje që i takojnë Rrëzës së qytetit. Fshatrat përreth Përmetit e konsiderojnë veten e tyre më të ngritur nga ana shoqërore dhe ekonomike, se banorët e fshatrave tjerë të krahinës së Rrëzës.

Megjithëse të gjithë banorët e Përmetit dhe të Këlcyrës e njohin veten si përmetarë, kur i pyesim disa

nga banorët e krahinave Shqeri, Cerje, Dangëlli, Rrëzë dhe vet qytetin e Përmetit, të cilët e quanin veten e tyre *“përmetarë të mirëfilltë”*, të përgjigjeshin, se nuk i njohin mirë traditat e Këlcyrës dhe Dëshnicës. Ata shpreheshin se si Këlcyra dhe Dëshnica nuk janë nga ana kulturore njëloj. Bile shpreheshin me një lloj përçmimi, sepse konsiderohen të një niveli më të ulët kulturor se përmetarët. Kjo sipas tyre vjen nga fakti që një pjesë e popullsisë ishin bujq raja dhe punonin si hyzmeqarë në tokat e bejlerëve të Këlcyrës dhe të teqesë së Sukës. Puna e bujkut shihej si një punë e rëndomtë nga banorët e tjerë në krahinat e Shqerisë, Cerjes, Dangëllisë dhe Rrëzës së qytetit, të cilët si rrjedhojë e kurbetit, mundën të krijonin një nivel më të lartë jetese se banorët e Këlcyrës dhe Dëshnicës.

Krahinat etnografike.

Krahinat e Përmetit shtrihen në të dyja anët e lumit Vjosë. Gjatë kohës së kryem kërkimin përmetarët na bënë një ndarje në 6 krahina të kësaj treve duke renditur Malëshovën, Dëshnicën, Shqerinë, Cerjen, Dngëllinë, dhe Rrëzën. Këtë të fundit e ndanin në dy njësi më të vogla Rrëzën e qytetit dhe Rrëzën e poshtme. Krahinën e Dervenit dhe Karamamutasit kujtohen vetëm si emërtime por nuk njihen si të tilla nga pjesa më e madhe e përmetarëve e në veçanti nga ata që kanë lindur pas viteve 50 të shekullit të kaluar.

Në krahun e majtë të Vjosës që i takon unitetit të Labërisë, përgjatë shpatit lindor të Dhëmbelit, shtrihen dy krahina të cilat i përkasin trevës së Përmetit: Malëshova dhe Rrëza. Këto krahina dallohen për *“një diferencim të vogël mes tyre, por me pjesët e tjera të Labërisë vihet re një diferencim më i madh”* (Zojzi 1950). Në anën e djathtë të Vjosës, në shpatin perëndimor të vargut malor Qarisht-Miçan-Kokojkë-Melesin (Qarisht-Dangëlli-Postenan) shtrihen Dëshnica, Shqeria, Cerja, dhe më në brendësi Dangëllia. Dëshnica ndodhet në të dyja anët e lumit me të njëjtin emër dhe paraqet një përafërsi më të madhe me Skraparin dhe Tomoricën. Shqeria, Cerja e Dangëllia paraqesin një ngjashmëri më të madhe në kulturën materiale e shpirtërore mes tyre si edhe me unitetin e madh të Toskërisë. Shqeria e Dangëllia kanë një shtrirje edhe jashtë kufijve administrativ të Përmetit, në Kolonjë dhe Skrapar.

Kushtëzuar nga një natyrë malore e relievit me toka të pakta, në formë rripash nëpër shpatet e maleve dhe pranë luginave të lumenjve, banorët e kësaj treve janë marrë me blegtori dhe bujqësi. Krahës bujqësisë dhe blegtorisë përmetarët janë marrë edhe me punë të ndryshme si sharrëxhinj, murator, kallajxhinj, mjekë popullorë e xherah (kirurg popullor). Kjo çoi në një ndarje të punës dhe krijimin e specialiteteve të veçantë mes krahinave të trevës së Përmetit. Nga ana tjetër rrethanat ekonomike për të siguruar jetesën i kanë detyruar përmetarët të marrin edhe rrugën e kurbetit. Ndarja e punës dhe kurbeti sollën një lloj diferencimi mes krahinave duke bërë që shumë banorë të Shqerisë, Cerjes, Rrëzës, Dangëllisë të kishin një nivel jetese më të ngritur se banorë të Dëshnicës, Rrëzës së Poshtme që nuk e përkrahën kurbetin.

1. Krahina e Malëshovës shtrihet në pjesën e poshtme të luginës së lumit të Zagorisë. Ajo kufizohet me Gjirokastrën në pjesën jugore, nga kurrizi i malit të Dhëmbelit dhe mali i Strakavecit (majë në m. Lunxhërisë); në veriperëndim me Tepelenën, nga mali i Strakavisës e malin e Golikut, duke zbritur poshtë në derdhjen e lumit të Zagorisë në Vjosë; në veri dhe verilindje kufizohet me Këlcyrën nga lumi i Vjosës; në perëndim ndahet nga krahina e Rrëzë me përroin e Rapckës.

Ngjashmërinë më të madhe kjo krahinë e ka me Labërinë prandaj njihet edhe si “Labëria e Përmetit”. Brenda krahinës përfshihen fshatrat: Leskaj, Limar, Kala, Malëshovë, Mbrezhdan. Fshatrat Argovë, Grabovë kanë ngjashmëri më të madhe me Malëshovën, por kanë patur më tepër lidhje me Këlcyrën. Etnografi Rok Zojzi këto fshatra së bashku me fshatrat Rapckë dhe Buhal i përmenden në Rrëzën e Këlcyrës²⁰. Gjatë kohës që kryem punën në terren banorët e fshatrave Rapckë dhe Buhal shpreheshin se fshati i tyre bënte pjesë në krahinën e Rrëzës së Përmetit.

Krahina e Malëshovës dallohet për një reliev malor alpin ndaj e quajnë edhe “Malësia e vogël e Përmetit”. Relievi alpin ka kushtëzuar edhe veprimtarinë ekonomike të kësaj krahine, blegtorinë. Tokat e punueshme janë të pakta. Për të siguruar jetesën banorët kanë praktikuar edhe kurbetin. Malishovitët

njihën edhe si punues të metaleve. Disa prej tyre punonin si kallajxhinj shëtitës brenda dhe jashtë vendit. Kallajxhitë e Mbretëdhënit përhapeshin edhe përtej Shkumbinit, në Dibër, në Kukës, në Tropojë e në Kosovë. Ata të Limarit dhe të Malëshovës punonin edhe në Greqi.

2. Krahina e Dëshnicës: shtrihet në veriperëndim të Përmetit midis malit Trebeshin në Perëndim, malësisë së Skraparit në Lindje, Qafën e Këçokut në Veri që e lidh me luginën e Osumit dhe të Beratin, dhe në Jug-Lindje hapet në drejtim të luginës së Vjosës. Lumi me të njëjtin emër përshkon këtë krahinë nga Veriu në Jug. Në të djathtë të këtij lumi, në shpatin lindor të Trebeshinës, shtrihen fshatrat: Kondas, Mazhanj, Psar, Ball, Çorogun (Ujmirë), Podgoran, Podgoran Fushë, Kodrisht, Katundisht, Këlcyrë fshat dhe Këlcyrë qytet; në të majtë të lumit ndodhen: Bubësi I, Bubësi II, Beqaraj, Kumarak, Toshkësi, Vinokashi I, Vinokashi II, Ballaban, Kajcë, Pavar, Fshat i Ri, Rodenj, Shelq, Zhepov, Sukë, Topojan, Xhanaj, Luar, Leskovec, Mërtinjë, Goricë, Bënja e Dëshnicës, Tolar, Panarit, Fratar, Seniçan, Riban, Varibop, Bedyqas, Kuqar. Në tradita e zakone ngjashmërinë më të madhe kjo krahinë e ka me Skraparin.

Dëshnica dallohet në përgjithësi për reliev kodrinor. Përgjatë luginës së lumit me të njëjtin emër shtrihet një fushë e gjerë 1km dhe e gjatë 5-6 km. Banorët e kësaj krahine janë marrë me blegtori, dhe më tepër me vreshtari dhe drurët frutorë, ndërsa në zonën e luginës së lumit me të njëjtin emër është e zhvilluar bujqësia. Tokat bujqësore, para Luftës II Botërore, punoheshin nga një popullsi “raja” që populli i njeh me emrin bujq. Kurbeti është më pak i zhvilluar kryesisht në fshatrat në kufij me krahinën e Cerjes. Banorët e kësaj krahine ishin të specializuar në përgatitjen e rakisë, pekmesit, dhe likove.

3. Krahina e Cerjes, shtrihet midis Dëshnicës, Shqerisë, Dangëllisë. Në veriperëndim, si kufij ndarës me Dëshnicën është përroi i Pacomitit. Ndërsa në juglindje ndahet me Shqerinë nga përroi i Bërçës²¹ dhe lumi Lengarica, duke përfshirë të gjithë fshatrat e pellgut ujëmbledhës të këtij lumi. Me Dangëllinë ndahet nga lumi i Kreshovës dhe pylli i bredhit të Hotovës. Nga pikëpamja e karakteristikave etnografike kjo krahinë përngjan me tepër me atë të Dangëllisë.

Përfshin fshatrat: Piskovë, Pacomit, Alipostivan, Raban, Pagri, Odriçan, Borockë, Hotovë, Kosovë, Gosnisht, Zhleusë, Mokricë, Mokrisë e Re, Kosinë, Kutal, Bodar, Tremisht, Lupckë, Novoselë, Qilarisht, Velçisht.

Fshati **Borockë** është futur herë pas here në zonën etnografike të krahinës së Dangëllisë. Banorët e këtij fshati vet shprehen se “*fshati i tyre bën pjesë në krahinën e Cerjes*”. Pacomiti në periudha të ndryshme kohore për nevoja administrative ka kaluar herë me Dëshnicën e herë me Cerjen. Për fshatrat Novoselë, Qilarisht dhe Mali i Bardhë banorët gjatë bisedave në terren na thanë se në tradita ngjajnë dhe me Shqerinë dhe me Cerjen. Shpesh ato renditen në krahinën e Cerjes. Mokrica e Re është quajtur vendbanimi i Ri me toponim Muçenj. Fshatrat Lupckë, Gosnisht dhe Novoselë sot janë braktisur e nuk banohen më, pasi banorët janë larguar në fshatra të tjerë të trevës së Përmetit, por edhe në qytete të tjera si dhe jashtë vendit. Në kujtesë e popullit janë memeorizuar edhe disa fshatra të cilët janë shkatërruar nga pushtuesit osman. Të tillë janë Stropani dhe Kamencka.

Relievi i kësaj krahine është kodrinoro-malor dhe përshkohet nga përrenj të shumtë që gjatë stinës së dimrit sjellin prurje të shumta e bëhen të pakalueshëm. Fshatrat janë të vendosur përgjatë shpateve të kodrave deri në lartësinë 800-1000m. Tokat bujqësore janë të përhapura përgjatë pllajave kodrinore dhe luginave të përrenjve. Për të siguruar jetesën banorët e kësaj treve kanë zhvilluar shumë emigrimin, me fillesë në Rumani, Turqi dhe Egjipt dhe në fillim të shekullit të kaluar në Amerikë.

4. Shqeria shtrihet në lindje të rrethit të Përmetit. Pjesa lindore e kësaj krahine i përket Përmetit, ndërsa pjesa perëndimore Kolonjës. Kufizohet në Veri me luginën e Lengaricës, në Jug e Jug-Perëndim me luginën e Vjosës së Sipërme, në Lindje e Jug-Lindje me Leskovikun. Përfshin fshatrat: Bënjë, Ogdunan, Delvinë, Trebozhisht, Lipivan, Petran, Izgarë, Iliarë, Munushtir, Melan, Çarçovë, Perat; ndërsa fshatrat Kovaçisht, Gjirakar, Peshtan, Radomisht, Lashov, Postenan, Radov, Leskovec, Cerik, Poda, Radanj me ndarje administrative i kanë kaluar Kolonjës. Fshati Zerec dhe Fshatrat Melan, Perat, Mali i Bardhë dhe Vinja janë braktisur.

21 Me këtë emër njihet vendbanimi i hershëm i fshatit Bënjë, që ruhet në kujtesën e banorëve të vjetër të këtij fshati.

sur që nga gjysma e parë e shekullit XX, ndërsa fshati Izgarë është braktisur pas viteve 1975-1980.

Fshatrat që hyjnë në këtë krahinë paraqesin një unitet më të madh me Cerjen dhe deri diku edhe me Dangëllinë përsa i përket traditave materiale e shpirtërore. Mundësia e komunikimit midis krahinës së Cerjes dhe të Shqerisë kanë bërë të mundur që të krijohen tipare të përbashkëta mes të dy krahinave duke e shprehur këtë edhe në një unitet më të ndjeshëm mes tyre, krahasuar me krahinat e tjera të trevës së Përmetit. Në përafrimin e këtyre traditave kanë ndikuar edhe lidhjet e ndërsjella martesore që janë bërë mes fshatrave të të dy krahinave etnografike.

Karakteri i relievit është kodrinoro-malor që kushtëzon edhe jetën ekonomike. Fshatrat janë të vendosur në shpatet e kodrave dhe rrëzë maleve dhe dallohen për përgatitjen e zahireve të dimrit dhe për mikpritjen. Si rrjedhojë e praktikimit të kurbetit fshatrat e kësaj krahine arrijnë në nivel më të lartë ekonomik krahasuar me krahinat e tjera.

5. Dangëllia shtrihet në Veri-Lindje të rrethit të Përmetit. Kjo krahinë ka karakter kodrinoro- malor të relievit. Kufijtë e kësaj krahine shkojnë midis lumit Osum në veri, luginës së lumit të Lengaricës në Jug, luginës së lumit të Kreshovës në Veri-Perëndim dhe Bredhit të Hotovës në Perëndim. Lumi i Kreshovës dhe pylli i Bredhit të Hotovës e ndan Dangëllinë nga krahina e Cerjes, ndërsa lumi i Lengaricës nga Shqeria. Një pjesë e Dangëllisë shtrihet edhe në Kolonjë.

Në këtë krahinë etnografike fshatrat që përmbledh Përmeti janë: Miçan, Vërçisht, Gostomickë Kreshovë (Kreshova nga lugina e lumit ndahet në të Dangëllisë dhe të Cerjes), Soropull, Frashër, Zavalan, Shijan, Ogren, Gostivisht, Kostrec; fshatrat që i takojnë Dangëllisë së Skraparit janë: Kakos, Qeshibes, Stërnec, Nikollarë; fshatrat që i takojnë Leskovikut (Kolonjës): Radovickë, Qinam, Leuckë, Kurtës, Mesiçkë, Zharkanj, Vitisht, Kaduçe, Novosel, Kagjinasi, Piskal, Bënjëz, Mbrezhdan, Rajau, Dermal, Kurisk (Kamnik), Bramazh. Fshatrat: Kakos, Qeshibesh, Stërnec sot janë pjesë e Skraparit.

Gjatë pushtimit turk kjo zonë lidhej administrativisht me Janinën e si qendër më të afërt kishte Përmetin. Qendrat më të afërme me tregun kanë qenë Përmeti dhe Korça. Edhe Frashri ka luajtur rolin e një qendre të vogël tregtare deri në Luftën I Botërore, kur u dogj e u shkatërrua nga ushtria greke për të fundit herë.

6. Rrëza shtrihet në shpatin perëndimor të malit të Dhëmbelit e të Nëmërçlës, ndahet nga Cerja dhe Shqeria nga lumi Vjosë. Kjo krahinë përfshin fshatrat: Lipë, Përmet (qytet), Leusë, Lëshicë, Badlonjë, Petrani, Gjinkar, Kaludh, Musakar, Strëmbec, Pëllumbas, Kanikol, Draçov, Zhepa, Biovizhd, Vllahopsilloter. Fshatrat: Lipë, Leusë, Lëshicë, Badlonjë së bashku me qytetin e Përmetit, që janë të vendosur në rrëzë të malit të Dhëmbelit, njihet nga përmetarët si Rrëza e qytetit. Ndërsa fshatrat: Petran, Gjinkar, Kaludh, Musakar, Strëmbec, Pëllumbas, Kanikol, Draçov, Zhepa, Biovizhd, Vllahopsilloter, që shtrihen në rrëzë të malit të Nëmërçkës, njihet si Rrëza e Poshtme. Banorët e Rrëzës së qytetit e konsiderojnë veten e tyre përsa i takon traditave të një niveli më të lartë duke u shprehur *“se jemi ndryshe nga banorët e Rrëzës së Poshtme”*. Këta të fundit quhen “rrëzjotë”. Banorët e Rrëzës së Përmetit, të Shqerisë e të Cerjes, të cilët ndoqën kurbetin dhe krijuan një nivel më të lartë në mënyrën e jetesës, shprehin një lloj nënvleftësimi për banorët e Rrëzës së Poshtme. Ata kanë përdorur edhe epitete ofenduese si “gjizanik”, “druvar”, që ua kanë vendosur sipas mënyrës së të ushqyerit dhe profesionit të përhapur të banorëve të Rrëzës së Poshtme.

Në kujtesën e banorëve të kësaj krahine janë memorizuar edhe fshatrat Mesukar dhe Këndref, të cilët janë shkatërruar si qendra banimi nga pushtuesit osmanë. Rrënojat e këtyre fshatrave tregojnë se dikur ato kanë qenë të banuara. Në vendin e kishës së fshatit Këndref akoma edhe sot ndizen qirinj dhe organizohen panairë.

Kramamutasi dhe Derveni, emri i të cilëve është i lidhur me ndarjen administrative që bëri Porta e Lartë në kazanë e Përmetit më 1432, megjithëse janë njohur edhe para vitit 1920, nuk janë memorizuar në kujtesën e banorëve të kësaj treve.

Karamamutasi shtrihet në Jug-Lindje të Përmetit dhe përfshinte fshatrat Perat, Çarçovë, Iliarë; **Derveni** përfshinte fshatrat Grabovë, Argovë, Buhal, Rapckë. Banorët e Grabovës dhe Argosvës thonë se më

shumë ngjashmëri kanë në tradita me Malëshovën por lidhjet tregëtare i kishin me Këlcyrën. Banorët e fshatrave Rapckë dhe Buhal pranojnë se janë më afër nga traditat me Rrëzën e Përmetit. Këto dy krahina nuk janë memorizuar në kujtesë dhe për më tepër nuk njihen nga brezi i moshës së mesme, pasi u shkrinë me krahinat fqinje.

Përfundimet

Ndryshimet kulturore dhe etnike, si rrjedhojë e modernitetit dhe globalizimit të shoqëruara me lëvizje të shumta demografike, sollën zhvillimin e debatit mbi përcaktimin e rajoneve a zonave kulturore në shumë fusha të dijes humane. Debati i zhvilluar mbi nocionin “vend” për Mesdheun solli krijimin e një antropologjie të Mesdheut. Mes hulumtimeve të bëra në këndvështrimin analitik e krahasues mbi komunitetet fshatare mesdhetar, studiuesit e përcaktojnë Mesdheun si një rajon me ngjashmëri mes vendeve të ndryshme dhe me një diversitet të larmishëm brenda kufijve kombëtar të shoqërive mesdhetare. Ngjashmëria, nga njëra anë, buron nga uniteti i faktorëve gjeografikë, ekologjikë dhe “kontakti i përhershëm dhe i pashmangshëm” gjatë një periudhe mijërvjeçare mes popujve të Mesdheut, ndërsa diversiteti, nga ana tjetër, rrjedh nga fakti se të gjitha shoqëritë rreth Detit Mesdhe janë shoqëri komplekse dhe me *shumë larmishmëri brenda kufijve të tyre kombëtarë*.

Studiuesit shqiptarë të njohur me emrin etnolog/etnograf, në kushtet e zhvillimit të një “antropologjie në shtëpi”, në mënyrë analoge me antropologjinë e vendeve perëndimore, zonat kulturore, i identifikojnë me krahinat etnografike dhe i marrin *si kategori historike, që lindën, u zhvilluan dhe shkuan drejt transformimit të tyre* gjatë shekujve. Debati teorik u zhvillua mbi cilat baza dhe kritere do të bëhet klasifikimi i krahinave etnografike. Duke vlerësuar si metodologji të kërkimit punën në terren ata, rëndësi i kushtojnë elementeve etnografike, nuancave gjuhësore si dhe disa elementeve të tjera (antropologjike, psikologjike, etj.). Analiza e të dhënave gjuhësore, antropologjike, etnografike, historike, vënë në dukje një diversitet të larmishëm brenda shoqërisë dominante shqiptare.

Bazuar në veçoritë dhe nuancat gjuhësore dallohen dy grupet të mëdha krahinore të Shqipërisë, Gegëria në Veri dhe Toskëria Jug të lumit Shkumbin. Përveç dy variacioneve të të folurës shqipe, gegërishte dhe toskërishte, dallime vihen re edhe në veshjen e burrave, në mënyrën e të kënduarit dhe të të vallzuarit. Brenda dy grupeve të mëdha krahinore ekzistojnë krahinëza më të vogla që dallohen në nuanca të vogla gjuhësore, në kulturën materiale e shpirtërore si dhe disa norma e praktika të së drejtës zakonore të ruajtura në kujtesë.

Treva e Përmetit, është pjesë e grupit të madh krahinor të Toskërisë. E parë në këndvështrimin mikrokulturor, ajo paraqitet si një trevë multikulturore, e cila përfshin në vetvete disa njësi të vogla etnografike që Zojzi i quan “*rrathë etnografik*”²², por vet përmetarët i emërtojnë karahina.

Kjo trevë ndahet në tetë krahina etnografike: Malëshova, Dëshnica, Rrëza, Shqeria, Cerja, Dngëllia, Dervenit dhe Karamamutasit. Këto dy të fundit vijnë nga të dhënat burimore dhe janë të memorizuara në kujtesën e popullit. Krahinat shtrihen në të dyja anët e lumit Vjosë, që shërben si kufi ndarës mes dy uniteteve të mëdha me karakter etnografik individual, të cilat populli i njeh me emra të veçantë, Toskëri dhe Labëri. Labëria shtrihet në të majtë të rrjedhës së Vjosës, ndërsa Toskëria në të djathtë të saj. Vetën e tyre të vjetrit në të djathtë të Vjosës e quajnë “toskë”, ndërsa në të majtë të saj “lebër”. Në kufijtë ndërkrahinorë shumë fshatra kufitare paraqiten herë në njërin krahinë e herë në tjetrën, duke bërë që kufijtë të mos janë shumë të prerë e të qartë. Megjithatë sot të gjithë banorët e kësaj treve e identifikojnë vetën si përmetarë.

Lëvizjet e shumta të njerëzve brenda kësaj treve dhe më gjerë, lidhjet martesore, bashkë-veprimi ekonomik, si dhe ndryshimi ekonomik, shoqëror e politik të diktuar gjatë një periudhe të gjatë historike kanë bërë që kufijtë mes krahinave të jenë të paqëndrueshëm e jostatikë. Elementet kulturore të njërës apo të tjetrës krahinë vihen re në të dyja anët e kufirit ndërkrahinor. Si rrjedhojë vihet re një ngjashmëri e madhe mes krahinave të Përmetit.

Ngjashmërinë më të madhe në tradita e zakone e kanë krahinat e Cerjes, Shqerisë, dhe Dangëllisë. Këto krahina në kujtesën e banorëve mbahen mend se dikur janë quajtur Malaki dhe më vonë kanë marrë

emrin Dangëlli. Ato paraqesin një ngjashmëri më të madhe në kulturën materiale e shpirtërore mes tyre si edhe me unitetin e madh të Toskërisë. Si rrjedhojë e kushteve të ndryshme natyrore, ndarjeve të vogla administrative nga pushtuesit osman, afërsisë me qendrat e tregjeve, Cerja dhe Shqeria u shkëputën nga Dangëllia duke krijuar kështu krahina më vete. Krahina e Rrëzës paraqet ngjashmëri më të madhe me Cerjen dhe Shqerin. Krahina e Dëshnicës paraqet një përafërsi më të madhe me Skraparin dhe Tomoricën në mënyrën e të kënduarit. Krahina e Malëshovës, me karakter malor e njohur edhe si “Malësia e vogël e Përmetit” ngjashmërinë më të madhe në tradita e zakone e ka me Labërinë prandaj quhet edhe si “Labëria e Përmetit”.

Si përfundim, duke u nisur nga këndvështrimi mikrokulturor shoqëria shqiptare paraqitet me një diversitet të larmishëm mes krahinave etnografike. Lëvizjet e shumta të njerëzve kanë bërë që dallimet mes tyre të vijnë duke u zbehur dhe në kujtesë të ruhen pak elemente në formën e mbeturinave. Si rrjedhojë e modernitetit dhe globalizimit, ka ndodhur që kufijtë etnografikë dhe kufijtë e zonave kulturore të mos jenë të prerë e të qartë, por të paqëndrueshëm dhe fluidë.

Referencat:

Aceves, Joseph B., CA comment, *Current Anthropology* 20, 1979, p.85

Adhami, S., Vështrim mbi kulturën popullore të trevës së Përmetit, Tiranë, “Ada”, 2001. 15-21.

Alberta, D., The Mediterranean as an anthropological laboratory, *Anales de la Fundación Joaquín Costa*, No 16, 1999, p. 215-232,

Appadural, A., Theory in anthropology: Center and periphery, *Comparative Studies in Society and History* 283, 1986, p. 56-61.

Bardhoshi, N., Teoria etnografike e Rrok Zojzit mbi të drejtën kanunore. Një vështrim kritik, *Kultura Popullore* 1-2, QSA, 2009, p.59-94.

- Për një antropologji të modernitetit shqiptar, Tradita etnokulturore dhe bashkohësia, QSA, IAK-SA, Tiranë, 2011, p.131-136.

Black-Michaud, I, Cohesive force. Feud in the Mediterranean and the Middle East, Oxford, Blackwe II, 1975.

Blok, A., Rams and billy-goats: A key to the Mediterranean code of honour, *Man* (N. S.)16, 1981, p.427-40.

Boas, F. , Race Language and Culture, The Macmillan Company, New York, 1940.

Boissevan, J. , Hal-Farrug: A village in Malta. New York: Holt, Rinehart and Winston. 1969

- Toward an anthropology of the Mediterranean, *Current Anthropology* 20, Nr. 1, 1979, p. 81-93.

Braudel, F., The Mediterranean and the Mediterranean World in the Age of Philip II. Vol.2, transl. by Sian Reynolds, New York: Harper & Row, 1972.

Brown, N., Friedrich Ratzel, Clark Wissler, and Carl Sauer: Culture Area Research and Map-ping, University of California, Santa Barbara, CA, Web archive, 2001, <http://www.csiss.org/classics/content/15>;

Campbell, J. K., Honour, family and patronage: a study of institutions and moral values in a Greek mountain community. Oxford: Clarendon Press, 1964.

Cana, J., Labëria vështrim etnografiko historik, Argjiro, 2014.

Davis, J., The people of the Mediterranean, London, Routledge, 1977.

Dragoj N., Dëshnica dhe dëshnicarët, Mokra, Tiranë, 2005.

Erickson, P. A., & Murphy, L. D., A history of anthropological theory (2nd ed.). Peterborough, Canada: Broadview Press, 2003.

Esteve-Fabregat, C., CA Comment, Current Anthropology 20, 1979, p. 405-408

Fajalori enciklopedik shqiptar, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë, 1985, faqe 543

Freed, Stanley A. and Freed, Ruth S., Clark Wissler 1870-1947, A Biographical Memoir, National Academy of Sciences, Washington D.C., 1992, p. 469-496.

Geertz, C., Islam Observed: Religious Development in Morocco and Indonesia. New Haven: Yale University Press, 1968.

Gilmore, David D. Anthropology of the Mediterranean area, Annual Review of Anthropology 11, 1982, p. 175-205.

- Honor and shame and the unity of the Mediterranean, Washington, D.C., American Anthropological Association, 1987.

Gulick, J., The Middle East: an anthropological perspective, Pacific Palisades, Goodyear Publishing Company, 1976.

Gupta, A. & Ferguson, J., Anthropological Locations: Boundaries and Grounds of a Field Science, University of California Press. 1997.

- Beyond "Culture": Space, Identity, and the Politics of Difference, Culture Poëer Place: Explorations in Critical Anthropology, Durham, N.C. and London: Duke University Press, 1999, p.33-51.

Gjinari, J. & Shkurtaj, Gj. Dialektologjia, SHBLU, Tiranë, 2000, 1997.

Gjinari, J., Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe, Studime Filologjike 4, 1964, f. 127-144.

Harris, M., The Rise of Anthropological Theory: A History of Theories of Culture, Rowman Altamira, 2001, p. 374.

Haxhihasani, Q., Kërkime dhe vëzhgime folklorike në rrethin e Përmetit, Studime filologjike, Tiranë, Nr. 2. 1959.

Herzfeld, M., Honour and Shame: Problems in the Comparative Analysis of Moral Systems, Man, New Series, Vol. 15, No. 2, Royal Anthropological Institute of Great Britain and Ireland, 1980, p. 339-351.
<http://www.jstor.org/stable/2801675>

- Anthropology through the looking-glass. Critical ethnography in the margins of Europe, Cambridge, Cambridge University Press. 1987.

Hopkins, N., More on Mediterranean anthropology, Current Anthropology 21, 1980, p.276-277.

Kola V, Bënja e Përmetit, Botimet Enciklopedike, Tiranë, (2002),

Krasniqi, M., Krahinat etnografike të Kosovës, Gjurmë e gjurmime, 1982, f. 14-28.

Kroeber, A. L., The culture-area and age-area concepts of Clark Wissler. In S. A. Rice (Ed.), Methods in social sciences, Chicago: University of Chicago Press, 1931, p. 248-265

- Cultural and Natural Areas of Native North America, University of California Press, Berkeley, CA., 1939.

Loizos, P., Politics and patronage in a Cypriot village, 1920-1970, 1977, p.115-137.

Loli, Dh., Përmeti dhe trevat e tij deri në vitin 1912, Luarasi, Tiranë, 2000.

Memuashaj, R., Historia e Kurveleshit I, Toena, Tiranë., 2004.

Muka, A. , Krahina Etnografike e Podgurit (Kosovë). Në Vështrim të Etnologut, Revistë shkencore PERLA, Viti X 2005 Nr. 1 (36), Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, 2005, f.119-128.

PaulsE. P., Cultural Area, Anthropological Concept, Encyclopædia Britannica, 2009. <https://www.britannica.com/topic/culture-area/Merging-relativism-and-cross-cultural-comparison>,

Pitt-Rivas, J.A., Mediterranean countrymen: essays in the social anthropology of the Mediterranean, The Hague - Paris, Mouton. 1963.

Schneider, J., On vigilance and virgins, Ethnology 10, 1971, p. 1-24.

Schneider,S.C.&Barsoux,J-L., Managing Across Cultures, Pearson Education, 2 edition, 2003.

Silverman, S., “Defining the anthropological Mediterranean: before Aix 1966”, Dionigi Albera, Anton Blok and Christian Bromberger (eds.), L’anthropologie et la Méditerranée: unité, diversité et perspectives, Paris: Éd. de la Maison des Sciences de l’Homme. 2000.

Shkurti, S., Vështrim etnografik mbi zonën e Vurgut (Sarandë), Etnografia shqiptare VIII, 1976, f. 112-157.

Tirta M.; Dojaka A; Selimi Y., Veshjet Popullore Shqiptare, Vol. 2, TOENA, Tiranë, 2001.

Wissler, C., Societies of the Plains Indians, Anthropological papers of the American Museum of Natural History, Vol.XI, AMS Press, New York, 1916/1975, ISBN 0-404-11918-2 ,

- The American Indian. Oxford University Press, New York, 1917.

Xhangolli, A. & Tyto, N., Këngë popullore të rrehtit të Përmetit, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, IKP, Tiranë. 2006.

Zojzi, Rr., Raport i ekspeditës etnografike në luginën e Vjosës, 8 Maj- 16 Qershor. Arkiv i IAKSA, 1950.

Zojzi, Rr., Ndarja Krahinore e Popullit Shqiptar, Etnografia Shqiptare I, Tiranë, IH-ASH, 1962, f. 16-64.

Përmbledhje

Në këtë punim do të trajtoj kuptimin e rajoneve kulturore brenda një hapësire me diversitet të larmishëm, të parë në këndvështrimin etnografik. Hulumtimet e zhvilluara nga antropologët a etnografët mbi fshatin mesdhetarë, tregojnë se shoqëritë rreth Detit Mesdhe janë komplekse. Ato kanë ngashmëri, por me një larmishmëri të madhe brenda kufijve kombëtarë të vendeve të ndryshme. Studiuesit në vendet e Europës Lindore e Ballkan, si kurse edhe ata shqiptarë, që i zhvilluan kërkimet e tyre brenda kufijve shtetëror dhe në focusin mikrokulturor, në mënyrë analoge me antropologët perëndimorë, i kanë identifikuar rajonet kulturore me krahinat etnografike.

Krahinat etnografike u formuan gjatë një procesi të gjatë historik si rrjedhojë e një bashkëpunimi ekonomik dhe social kulturor. Përcaktimi i kufijve të tyre është i vështirë. Faktorët shoqëror, elementët e kulturës materiale e shpirtërorer, që i dallon nga njëra tjetra, mund të gërshetohen, zhduken apo dhe njësohen. Elementët e njërës krahinë apo të tjetrës paraqiten në të dyja anët e kufijve ndërkrahinor. Rast studimi është Përmeti, një trevë e krahinës së madhe etnografike të Toskërisë në Jug të Shqipërisë. Ajo ndahet në tetë krahina etnografike: Malëshova, Dëshnica, Rrëza, Shqeria, Cerja, Dangëllia, Derveni dhe Karamamutasi. Si rrjedhojë e lëvizjeve të popullsisë, lidhjeve martesore, bashkveprimet ekonomik të diktuar nga koha, si dhe ndryshimet ekonomike, shoqërore e politike kanë bërë që kufijtë me tyre të jenë të paqëndrueshëm e të vijnë duke u zbehur.